



---

# Raport vjetor 2015

**QENDRA RINORE ARDHMERIA – KLINE/KOSOVO**

**1 Janar & 31 Dhjetor 2015**

**PERGADITUR NGA: VITORE ZEFI**

**ME 31/12/2015**

**KLINË**



## Hyrje:

Qendra Rinore është themeluar në vitin 1999, që prej këtij viti qendra organizon aktivitete për të rinjë dhe gjithashtu edhe këtë vit kemi implementuar projekte rinore. Në këtë raport janë të përmbledhura të gjitha aktivitetet dhe projektet e realizuara mbrenda Qendres Rinore Ardhmeria gjatë vitit kalendarik 2015.

*Aktivitetet e qendres rinore të cilat janë zhvilluar dhe janë të vazhdueshme:*

1. **KURSET E PËRDITESHME.**
2. **AKTIVITETET DHE INICIATIVAT RINORE**
3. **BASHKËPUNIMET DHE PARTNERET**
4. **STATISTIKAT /PËRFITUESIT**



## **1. KURSET E PËRDITESHME:**

### **1.1 Kursi Gjuhës Angleze**

Në form të rregullt është organizuar kursi I gjuhës angleze për fëmijë, të rinjë dhe të rritur çdo ditë, gjatë këtij viti kanë përfituar shumë pjesëmarrës të cilët kanë ndjekur kursin e gjuhës angleze, të rinjët kanë pasur mundësi të marrin pjesë në kursin e organizuar nga lehtësuesi lokal dhe gjithashtu edhe në kursin e dukimit jo-formal nga lehtësuesi evropian.

### **1.2 Punëtorit për fëmijë**

Gjatë javës kemi zhvilluar puntori të rregullta kreative për fëmijë dhe kemi krijuar një ambient të sigurtë që ata mund të punojn gjëra të ndryshme nga letrat e përdorura, qeset e plastikes etj. Në një mënyrë që fëmijët të edukohen për të mbrojtur ambientin.

### **1.3 Kursi Gjuhës gjermane-**

është organizuar kurs për të rinjët që dëshirojnë të mësojnë gjuhën gjermane, dhe gjatë vitit është punuar më tri grupe të ndryshme.

### **1.4 Kursi gjuhës Shqipe-**

Qendra jonë gjithashtu siguron edhe kursin e gjuhës shqipe për të rinjët evropian që jetojnë në klinikë për një periudhë të gjatë dhe dëshirojnë të mësojnë shqip, gjatë këtij viti një vullnetar lokal ka mësuar gjuhën shqipe 2 vullnetareve evropiane.

### **1.5 Cisco netëoring academy**

prej muajit mars 2014 ne jemi pjesë e shkolles akademike Cisco dhe mbrenda qendres rinore organizojm kursin e avancuar të IT-së në Klinikë.

## **2. AKTIVITETET & INICIATIVAT RINORE:**

### **2.1 Aktivitet Humanitar**

Idea për të rritur ndjenjen e humanizmit tek të rinjtë, Qendra Rinore ka grupe Rinore që dëshirojnë të japin kontributin e tyre dhe të ndihmojnë njëziti në nevojë siq janë rastet e familjëve të varfëra dhe gjithashtu edhe në rastet e semundjëve të ndryshme. Rasti i një vajze të re e cila është diagnostifikuar me Leukaemia acita myeloides vendosem ta japim përkrahjen tonë, të rinjtë organizuan aktivitete që krijojnë fonde siq janë: shitja e tortave & shfaqje e filmit. Të hollat e mbledhura janë dërguar tek familjaret e vajzes së diagnostifikuar.

*Shkurt 2015, Klinë*

### **2.2 Ngjarje kulturore**

Për herë të parë Organizata jonë ka vendosur të këtë një bashkëpunim me shtetin e Lituani dhe të rinjtë tonë për herë të parë kanë mundësinë të njohin për së afërti një kulturë shumë të ndryshme nga Kultura jonë shqiptare.

Për t'u njoftuar më mirë është organizuar një ngjarje ku të rinjtë tonë mund të prezantojnë Kosovën dhe qytetin e Klinës, ndërsa vullnetarja nga Lituania (EVS) prezantoi jetën e një të riu në Lituani, kulturën e tyre dhe traditat e vendit. Pjesa e dytë e Ngjarjes ishte një darkë ndërkulturore ku secili prej 10 të rinjëve të Klinës kanë përgaditur disa lloje të ushqimit tonë tradicional ndërsa vullnetarja europiane kishte përgaditur ushqimin e tradites lituaneze. Mbrëmja ishte shumë e mirë dhe të rinjtë ishin shumë të lumtur që mund të krenohen me ushqimet tona Kosovare dhe gjithashtu të mesojm si ti vlersojm dhe promovojm ato.

*7 mars 2015, Klinë*

### **2.3 Dita e ujit “**

Për nder të “Ditës së ujit” vullnetaret e grupit Rinor “Klina Youth Chapter” kanë zhvilluar aktivitete në shkollën e mesme të ulët “Ismet Rraci” –Klinë. Ku prej grupit morën pjesë 11 vullnetar dhe rreth 32 fëmijë. Për këta fëmijë u organizuan Lojra të cilat ishin sportive dhe kreative për fëmijë, aktivitetet filluan prej orës 12:00 deri 14:00, të gjithë fëmijët ishin të kënaqur dhe të gjitha aktivitetet u zhvilluan me iniciativën e grupit rinor në mënyrë që të promovojnë rëndësinë, ruajtjen dhe kursimin e ujit.



*22 mars 2015*

## 2.4 Global youth Service day-Pastrimi i parkut të malushganit

Për të shënuar ditën globale dhe për të bërë ndryshime në ambient grupi rinor "Klina youth chapter" organizoi një anketë për qytetaret në menyrë që të kemi përkrahjen e tyre për të realizuar një iniciativë rinore.

Prej rezultatit që patëm me anketimin e qytetareve grupi rinor vendosi që të filloi me pastrimin e parkut të qytetit, gjithashtu kjo iniciativë u mbështet edhe nga Drejtoria e shërbimeve publike ku edhe mbuloi pjesën e materialit për mbledhje të mbeturinave. Grupi rinor mbledhi rreth 40 të rinjë të cilët punuan gjatë dy ditëve për të pastruar një pjesë të parkut por fatkeqësisht qytetaret e asaj zone nuk përkrahen këtë iniciativë edhe përkunder premtimeve të tyre në anketat paraprake. Qëllimi i iniciativës ishte që të rinjtë të fillojnë me pastrim të mbeturinave dhe qytetaret të vazhdojnë me pastrimin e pjesës tjetër dhe mirëmbajtjen e saj por mjerisht kjo nuk ndodhi në qytetin e Klinës.



### **Bashkëpunoret:**

Klina youth chapter

Drejtoria e shërbimeve publike & Shkolla fillore " Ismet raci"

22 Prill 2015

## 2.5 Qendra Edukimit në Klinë

Në kuader të projektit " BE/KE Përkrahje për promovimin e Diverzitetit Kulturor" janë organizuar një numër i madh i aktiviteteve dhe fillimisht kemi filluar me krijimin e një laboratorit që do të funksionoi si qendër edukimi në Klinë.

Fillimisht janë bërë takime me përfaqësues të shkollave dhe me tutje janë krijuar puntori për zhvillim të programit. Implementimi i programit të qendrës edukative filloi në muajin maj 2015, kemi arritur së bashku me institucionet lokale të krijojmë një laborator mbrenda shkollës profesionale "Fehmi Agni" në Klinë.

Laboratori gjindet afër Lumit Drini bardhë dhe të realizohen aktivitetet në këtë vend ishte shumë lehtë sepse të rinjtë mund ta eksplorojnë natyrën. Gjatë një muaji janë zhvilluar shtatë (7) aktivitete me tri (3) shkolla të ndryshme në bashkëpunim të mirë edhe me profesor. Puntorit të cilat janë realizuar janë: **Testimi i Ujit, Rëndësia dhe llojet e drurit, Gjetja e insekteve, Arti në natyrë, mbjellja e luleve, Dekompozimi i mbeturinave dhe krijimi i klubeve të ambientalistave.**



Aktivitetet janë zhvilluar në dy metoda: teorike dhe praktike (në natyrë). Qëllimi këtij programi ishte që të rrisim vetdijësimin nxënësve të shkollës për rëndësinë e natyrës dhe mbrojtjen e ambientit. Rëndësia më e madhe e programit ishte vullneti i nxënësve shkollor dhe interesimi i tyre për mësim, marrja e njohurive të reja për ambientin. Në secilin puntori nxënësit dhe profesoret e tyre ishin aktiv në diskutime dhe sqarimet e temave të ndryshme për ambientin.



#### **Përfundimi:**

Si Qendër Edukative tani me ekziston si një laborator në shkollën profesionale me material të cilin e kemi mundësuar gjatë punës së realizimit të aktiviteteve dhe gjithashtu edhe me përkrahjen e profesoreve dhe arsimtareve, ka shumë material që mund të përdoret në të ardhmen për edukimin e të rinjve për mjedisin.

*Maj 2015*

## **2.6 Procesi i konsultimit me komunitet**

Pasi që shpella e Dushit gjindet në teritorin e fshatit Dush dhe në rrethinë të fshatrave Sferkë, Vulljakë dhe Qupevë dhe këto fshatra kanë përfaqësues të tyre kemi parë të arsyeshme që të kontaktohen të gjithë përfaqësuesit e tyre në mënyrë që të organizojnë takime me qytetaret e vet në mënyrë që të arrijmë të organizojmë një fushatë pastrimi të mbeturinave dhe gjithashtu të diskutojmë për trashëgiminë natyrore dhe legjendave të cilat mund t'i ndajnë me neve, kemi përdorur metodologjinë e involvimit të grupeve konsultative dhe të kemi opinionet e katër fshatrave të ndryshme për shpellen e Dushit.

Në lidhje për të arritur mendimet për vizionin e përgjithshëm - një komunitet me rritjen e ndërgjegjësimit mbi mjedisin dhe biodiversitetin që sjell arsimin, kohën e lirë dhe peizazhin së bashku, ne kemi planifikuar për t'u konsultuar: komunitetin lokal për biodiversitetin dhe peizazhin, se si komuniteti e parashikon zonën e shpellës së Dushit dhe të ndajm informacione sa i përket projektit në vazhdim – shkëmbime të opinioneve të ndersjellta.

Konsultimet me komunitete në Klinë janë planifikuar si pjesë e procesit për mbështetjen e promovuese të shpelles së Dushit, kemi arritur për dy javë për të organizuar 4 takime konsultative me target grupe të ndryshme si:

- Përfaqesues të fshatrave.
- Mesues dhe komuniteti i fshatit Dush.
- Mesues, Drejtor të shkolles dhe komunitetit të Vulljakut.
- Komuniteti i fshatit Qupevë.
- Komuniteti i fshatit Sferkë

## 2.7 Fushata e pastrimit të shpella e Dushit

Fushata e pastrimit të Shpella e Dushit është organizuar me perkohjen e projektit “ BE/KE Përkrahje për promovimin e Diverzitetit Kulturor” dhe është implementuar nga Qendra Rinore Ardhmeria ne bashkëpunim me komunën e Klinës. Ky projekt ka mobilizuar komunitetin e katër fshatrave të ndryshme: Dush, Sferkë/a, Vulljakë/a dhe Qupevë/a të pastron zonën e tyre dhe të krijojn një ambient atraktiv për vizitorët e shpellës së Dushit në të ardhmen.

Komuniteti lokal mori pjesë 3 (tri) ditë në fushatën e pastrimit dhe në veqanti Komuniteti nga fshati Dush ishte mobilizuar dhe motivuar të përkrahë iniciativën tonë, mbrenda komunitetit kishte gjithashtu edhe të rinjë dhe fëmijë që punuan 3 ditë gjatë tërë kohës për të pastruar natyrën dhe në veqanti hyrjen e shpelles së Dushit dhe peizazhin përreth saj.



Në ditën e parë komuna e Klinës ka përkrahur më kamion plehrash për të larguar mbeturinat e ngurta nga zona e shpelles së Dushit dhe gjatë dy ditëve tjera kamionat e plehërave kanë

mbledhurar thaset e mbeturinave të mbledhura nga vet komuniteti në të gjitha 4 fshatrat në fund të ditës.

Gjatë fushates së pastrimit është arritur që të mbledhen 595 thasë të 160l me mbeturina, kamionat e plehrave dhe personat që kanë udhëhequr kamionat ishin shumë të befashuar nga ai mobilizim i pastrimit të mbeturinave. Në ditën e fundit të fushates gjithashtu edhe 15 të rinjë nga qyteti i Klinës i janë bashkangjitur komunitetit të Dushit në mënyrë që ti përkrahim në pastrimin e ambientit.

Ne ishim shumë të lumtur të shohim ndryshimet që janë bërë gjatë këtyre tri ditëve dhe në një mënyrë se si është e mundur që një iniciativë mund të bëjë ndryshime në shoqërinë tonë, komuniteti lokal i zonës së Dushit ka mirënjohur punën tonë grupore të organizatës dhe dëshirën e të rinjëve që janë të gatshëm të kontribuojnë në vendin e vet.



Zona e Shpelles së Dushit ka nevojë për më shumë iniciativë dhe gjithashtu aktivitete që do të krijojnë një ambient atraktiv për turistët që dëshirojnë të vizitojnë shpellën e Dushit.

*23 maj, 2015*

## **2. 8 Ngjarje Kulturore të Shpella e Dushit**

Ngjarja kulturore është organizuar me përkrahjen e projektit " BE/KE Përkrahje për promovimin e Diverzitetit Kulturor" dhe implementuar nga partneri lokal Qendra Rinore Ardhmeria. Target Groupi: Komuniteti i katër fshatrave , të rinjë & Institucionet e edukimit & Vizitor të jashtëm.

Pas 3 ditëve intensive të fushatës së pastrimit në 4 fshatra të ndryshme kemi organizuar Ngjarjen kulturore me qëllim që të promovojmë shpellën e Dushit dhe t'i falenderojmë të gjithë ata që moren pjesë në fushatë . Për herë të parë ishte duke u organizuar një ngjarje kulturore pranë kësaj shpelle dhe e cila mundësoi gjatë kësaj dite të këtë 170 vizitor. Në këtë event moren pjesë komunitete të të gjitha fshatrave përreth , të rinjë dhe nxënësit e shkollave.

Vizitorët u argetuan gjatë tërë ditës me aktivitete të ndryshme kulturore. Gjatë ngjarjes disa gra vendase përgaditen ushqim tradicional –Flija, njëziti mund të kënaqeshin me procesin e Përgaditjes së Flijes. Zona e shpelles së Dushit ishte përplotë me njerzë .



<https://www.youtube.com/ëatch?v=iXi9aDFZcoY>

Njëzit vallëzuan vallet tradicionale, kënduan këngë të tradites, përformuan lojra dhe tregime të vjetra. Mund të ndegeoje të qeshurat e fëmijëve dhe të shihje fetyra të buzëqeshura kudo tek secili njeri. Njëzit bisedonin me njëri tjetrin, duke ndarë tregimet e njëri tjetrit dhe duke u defryer me Kohen merkullueshme të pranveres. Kur Flijat ishin gati u ftuan të gjithë vizitorët të provojn flijen dhe të ndegeojen përformancat muzikore të përgaditura nga vet të rinjtë.

Ngjarja kulturore mori fund me aktivitetin e fundit të muzikes dhe shpërndarjen e njerëzve të dispounuar që kishin kaluar një ditë të mirë në natyren e tyre.

## 2.9 Ngjarje Edukative për Biodiverzitetin dhe Natyren

Ngjarja e Edukimit u realizua me mbështetjen e zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë. Grupi i synuar ishin fëmijët e shkollave fillore dhe ato të mesme, të rinjtë dhe qytetaret e Klinës.

Për të përmbledhur të gjitha aktivitetet që kishim me fëmijët e shkollave të Klinës në Qendren e Edukimit, një të dielë kemi organizuar ngjarje edukative për biodiverzitetin dhe natyrën. Ngjarja Edukative është zhvilluar në shkollën profesionale "Fehmi Agani" në Klinë Qëllimi i këtij aktiviteti ishte rritja e ndërgjegjësimit të mbrojtjes së mjedisit dhe riciklimit të mbeturinave.



<https://www.youtube.com/watch?v=AETTF1Eee6c>

Në Ngjarjen e Edukimit kemi pasur 3 punëtori të ndryshme në çështjet e mjedisit dhe në mënyrë të arsyeshme përdorimi i mbeturinave dhe mbrojtja e natyres. Fëmijët ishin shumë



të gëzuar në lojrat e procesit të bërjes flluska sapuni. Ajo ishte shumë qesharake dhe të gjithë donin që të provonin se si ta bëjnë një Bubble. Për më tepër fëmijët patën mundësi të bashkohen në lojrat grupore me ujë ose për të krijuar rathë dore nga bimët dhe shishet e plastikes, me qëllim për ripërdorimin e plastikes. Gjithashtu kemi ekspozuar edhe fotografitë nga seria e fundit e aktiviteteve për biodiversitetin dhe natyrën.

Në atë rast kemi pasur një mysafir të veçantë – përfaqesuesen e Këshillit të Evropës në Kosovë. Ajo ishte shumë e lumtur në lidhje me aktivitetet dhe ëorkshopot e realizuara dhe me të vërtetë ishte e gëzuar për punën e realizuar deri me tani.

Theksi kryesor i kësaj ngjarje shfaqja e sfilates së modës nga mbeturinat e recikluara. Fëmijët u paraqiten në skenë me rrobat e bëra nga ripërdorimi i qeseve të plastikes, shishet dhe materiale të tjera. Fëmijët dhe vizitorët ishin shumë të lumtur dhe të gëzuar për këtë performancë. Dhe më e rëndësishmja është dhe shpresojmë që fëmijët të kenë kuptuar problemin e mbeturinave dhe Rëndësine për tu kujdesur për natyrën.

## 2.10 Maratona e biçikletave 2015

Ashtu si çdo vit qendra rinore Ardhmeria organizoi Gjysm maraton të biçikletave me qëllim që të rinjtë të marrin pjesë në aktivitete sportive dhe njëkohësisht të ruajn ambientin dhe shendetin e të rinjëve. Gjysm Maratona e Biçikletave u realizua në distance prej 16km, në këtë garë morën pjesë 11 të rinjë të moshës 14-18 vjeqë, ku prej tyre garuese femer ishte vetem një vajzë.



### Fitues të gares:

Vendi 1- Anton Perlleshi -32.3 min

Vendi 2- Drilon Hoti-35.52 min

Vendi 3-Alfons Gojani-36.40 Min

Bashkëpunor: Sektorin e Sportit-Xhafer Ademin,  
Shërbimin Policor të Kosovës dhe Qendra Klinke e mjekësis Familjare " Nënë Tereza"- Klinë

## 2.11 Krosi i Vrapimit për fëmijë 2015

Në bazë të aktiviteteve të përditshme shihet qartë dëshira e madhe e fëmijëve për aktivitete sportive dhe në për këtë arsye Qendra Rinore vendosi të zhvilloi Krosin e Vrapimit në 2 distanca - prej 600 m dhe 300 m. Në Krosin e Vrapimit të 300m morën pjesë fëmijët e moshës 6-8 vjeqë, ndersa në Krosin e Vrapimit të 600 m morën pjesë fëmijët e moshës 9-12 vjeqë.



Në këtë aktivitetet morën pjesë rreth 40 fëmijë të cilët ishin me shëndët të mirë dhe me vullnet të mirë vrapimi, Nga të dy moshat fituesi është shperblyer me një medalje simbolike. Gjatë aktivitetit fëmijët ishin aktiv dhe shumë të kënaqur për të arriturat e tyre në Kros Vrapimi.

Pas përfundimit të garës vullnetarët e Qendres kanë shpërndarë broshura për fëmijë të cilat kishin mesazh edukues "Këshilla për të jetuar të shëndetshëm".

### **Bashkëpunor:**

Spektori e Sportit - Xhafer Ademi,  
Qendra Klinike e mjekësis Familjare "Nënë Tereza" Klinë

## 2.12 Festa 1 Qershori 2015- at Margarita kids

Dita nderkombëtare e fëmijëve është festuar edhe në qerdhen e quajtur "Margarita Kids" në fshatin Zllakuqan të Komunës së Klinës. Duke parë të arsyeshme që dita e fëmijëve të festohet në tërë botën dhe gjithashtu secili fëmijë meriton të shoh 1 Qershorin si një festë të veçantë.

Qendra Rinore "Ardhmeria" mundësoi që të organizoi disa lojra edukuese për fëmijë në "Margarita Kids" dhe ti gëzoj edhe fëmijët e fshatrave jashtë qytetit, në këto aktivitete morën pjesë edhe parashkolloret e Shkolles Ismet Raci-Klinë dhe " Shtjefen Gjeqovi-Zllakuqan",



## 2.13 Promovimi i Vullnetarizmit në Klinë

Duke parë të arsyeshme punën rinore dhe involvimin e madh të punës vullnetare në Klinë dhe njëkohësisht edhe inkuadrimin e vullnetareve evropian në qytetin e Klinës shohim si një obligim për të promovuar dhe shënuar ditën e vullnetarëve në Klinë.



Me 16 Korrik të vitit 2015 zhvilluam një event për të promovuar vlerat e punës vullnetare, gjithashtu gjatë tërë ditës të rinjët e rajonit paten mundësi që të ndëgjojnë për përvojat e vullnetarëve lokal dhe atyre evropian në mënyrë që këto informata të l'u shërbejnë edhe të rinjëve tjerë dhe të përfitojnë nga ato. Eventu vazhdoi me organizimin e lojërave për të rinjë, këngë dhe argetim nga ana e të rinjëve. Eventu u përmbyll me shkëmbimin nderkombëtar dhe viziten e grupit rinor nga Suedia ku mundën të

ndajn me të rinjët e Klinës qëllimin e vizites së tyre dhe bashkëpunimin e tyre me Qendrën Rinore Ardhmeria.

Ky event është përkrahur nga Osce në bashkëpunim me Qendrën Rinore Ardhmeria-Klinë  
*16 July at Kline*

## 2.14 Mbrëmje nderkulturore në Klinë,

Me 1 Shtator grupit punës të Qendres Rinore ju bashkëngjiti vullnetarja evropiane nga Estonia-Cairit Eit (EVS) për të punuar në periudhë prej 6 muajsh. Për të ndarë me të ditën e para në Qendër Rinore dhe në qytetin tonë të Klinës ne sadopak mundohemi që ti ndihmojmë për ta njohur vendin tonë dhe kulturën tonë prandaj një Grup I të rinjëve janë organizuar që tja prezantojnë vendin tonë dhe traditën kosovare. Gjithashtu edhe vullnetarja ka bërë një prezantim të vendit të saj dhe kultures së saj.



Gjithashtu si pjesë e kultures është edhe ushqimi ku të rinjët gjithashtu kanë përgaditur secili prej tyre ushqim tradicional dhe kanë ngrënë darkë së bashku në mënyrë që të provojn ushqimet dhe pijet e ndryshme nderkulturore.

## 2.15 Java Rinore në Klinë

Gjatë muajit shtator Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport në Klinë ka organizuar disa aktivitete për të rinjët e Klinës ku prej Qendres tonë moren pjesë disa të rinjë që janë aktiv pasi që iu dha një mundësi për të bërë vizita Rinore si vizitë tek Muzeu privat në Klinë- jJon Gjergji, Vizitë tek atelja e piktorit z.Idriz Berisha dhe Vizita Rinore tek Germimet Arkeologjike në Dersnikë.



Të gjithë të rinjët ishin të mahnitur për të gjitha vizitat sepse për herë ta parë vizitonin një muze që me heret nuk e dinin as që ekziston, paten mundësi të shohin pikturat e bukura të piktorit Klinas. Gjë që më se shumti ju ka lenë përshtypje ishin germimet arkeologjike ku të rinjët për herë të parë shihnin diçka të tillë dhe për se afër ti shihnin historin që ishte mahnitese në qytetin e tonë.

*Shtator 2015, Klinë*

## 2.16 Festa Halloween n' Klinë

Ngjarja Halloween u realizua me mbështetjen Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe Qyteza Café-Bar 1968.

Grupi i synuar: Banorët e Klinës

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti ishte për të mbledhur njerëzit nga Klina në mënyrë që të rrisë ndjenjën e komunitetit. Për të mbështetur këtë qëllim janë organizuar aktivitete të ndryshme për grupe të ndryshme.



Target Grupi kryesor ishin fëmijët të cilët ishin në gjendje për të marrë pjesë në aktivitete krijuese, si të tilla për përgatitjen e maskave dhe duke shijuar piktura në fytyrat e fëmijëve. Gjithashtu, ata patën një mundësi të shoqërohen me fëmijët e tjerë duke luajtur lojëra të ndryshme dhe për të parë film vizatimor. Aktivitetet janë zhvilluar para objektit komunal dhe ishin të suksesshme, moren pjesë rreth 170 fëmijë si edhe prindërit e tyre. Piktori i fundit përfundoi me vizatimin fytyrës të fëmijës së fundit në këtë ngjarje edhe pse ishte pasdite dhe errësira filloi të bie në qytet, kështu që fëmijët ishin të ngazëllyer me të vërtetë që të kenë një ngjarje të tillë në qytetin e Klinës.

Target grupi i dytë ishin të rriturit të cilët kishin një shans për ta ndier veten prap fëmijë në mbrendësin e tyre dhe të marrin pjesë në një party me kostume të ndryshme në lokalin kafe-bar Qyteza 1968 me DJ Robin (Robert Bojaj). Një mbrëmje e tillë festive dukej si një shtëpi e plotë ku të rinjtë dhe të rriturit panë të nevojshme këtë llojë ngjarje festive në qytetin e tyre.

31 Tetor 2015

## 2.17 Fësta e 20 Nëntorit

Festa e 20 nëntorit njihet si festë nderkombetare e të drejtave të fëmijëve, dhe kjo festë u shënuar në Klinë me iniciativën e Qendres Rinore "Ardhmeria", kjo initiative u përkrahë nga dy shkollat fillore të komunës së Klinës të cilat mundësuan që në shkollat e tyre të



organizohen puntori me fëmijët. Në shkollën Ismet Raci është punuar me 10 (dhjetë) grupe të fëmijëve ndersa në shkollën fillore "Motrat Qiriaz" është punuar me 5 grupe të fëmijëve.

Në Secilin grup ka pasur mundësi që të diskutohen të drejtat e fëmijëve, përgjegjësitë e tyre dhe janë munduar që mendimet e tyre ti shfaqin në letër.

Falenderojm Shkollat Fillore për bashkëpunim dhe sidomos mësueset e Edukates qytetare.

## 2.18 Festa e 28 Nëntorit- Gjetja e Thesarit

Festa e 28 Nëntorit u festua me të rinjët e qytetit të Klines dhe për këtë festë organizuam aktivitetin gjetja e thesarit që për të rinjët thesar janë njohurit tona për flamurin kombëtar.



Organizuam që tri grupe Rinore vizituan Komunen e Klinës, Shtepin e Kultures dhe një Historian në menyrë që të marrin njohuri për historin e flamurit dhe traditen tonë shqiptare. Disa grupe u këthyen me shumë njohuri të reja dhe ndan me grupet tjera përvojën e tyre gjatë vizitave, disa të rinjë vazhduan me pyetjet e tyre dhe me diskutimet se sa institucionet tona nuk i marrin për seriozisht të rinjët tonë, disa të rinjë kishin pikturuar flamurin dhe me fjalë të tyre u munduan që të prezantojn historin e flamurit shqiptar. Të rinjët festuan kënduan dhe Festa jonë u përmbyll me një tortë madheshtore që simbolizonte flamurin tonë.

*Falendërojm të rinjët për pjesëmarrje dhe shënim të festës së flamurit Kuq e Zi*

## 2.19 Fushata vetdijësuese HIV/Aids

**Qëllimi** i këtij projekti ka qenë të zhvillojm një fushatë edukuese për të rinjët e qytetit, për vetëdijësim dhe parandalim të sëmundjes Hiv/Aids dhe shënimin e javës ndërkombëtare të Hiv/Aids në Klinë.



Fushata vetdijësuese për Hiv/Aids është organizuar nga Qendra Rinore Ardhmeria me përkrahjen e Komunes së Klinës prej datës 1-4 dhjetor 2015, Fushata mundësoi realizimin e aktiviteteve edukative si shpërndarje të fletushkave vetëdijësuese për Hiv/Aids në 4 shkolla të qytetit të Klinës, organizimin e ëorkshopeve për të rinjë (grupeve punuese në teren),



interpretimin e lojrave kreative për parandalimin e sëmundjeve infektive dhe virusin Hiv, krijimin e pllakates së mbushur me mendimet e të rinjëve në të gjitha shkollat e qytetit të Klinës, Ligjeratë profesionale me mjekë dhe shfaqje teatrale nga grupi rinor.

IMPLEMENTUAR NË DHJTOR 2015, KLINË

## 2.20 Shpërndarja e Dhuratave

Me 29 dhjetor 2015 të rinjët e qendres rinore Ardhmeria shpërndan dhurata tek familjët me kushte të vështira ekonomike në komunën e Klinës, në mënyrë që ti përgadisnin këto dhurata të rinjët organizuan aktivitetet gjatë muajit dhjetor në mënyrë që të krijojnë fondin për të përgaditur dhuratat.

Aktivitetet që krijuan fonde janë:

1. Mbledhje të fondit nga bizneset Private
2. Shitje të kartolinave dhe gjërave Kreative në qytet (të punuara nga të Rinjët)
3. Ngjarje Kulturore “Talentët e Klinës 2015”

Gjatë realizimit të këtyre aktiviteteve patëm mundësi që të shohim ndjenjen e humanizmit nga insitucionet lokale, bizneseve private dhe qytetareve të rastit. Të gjitha këto aktivitete krijuan një fond që arritem të ndihmojm 6 familje me ushqim dhe veshmbathje dhe ti gëzojm fëmijët e tyre me dhurata për vitin e ri 2016.



Qendra Rinore „Ardhmeria“ falenderon të gjithë ata që kontribuan por në veqanti të rinjët falenderojn : Biznesin privat „Restorant- Residencë“ për kontributin e dhënë, si dhe qytetarin Elmi Qerkini I cili dhuroi 6 thasë miell për këto familje. Këto gjeste humane motivuan të rinjët tonë që gjithmonë të punojn dhe të kontribojn në mënyrë të vazhdueshme për të përkrahur familjët në nevojë.



## 2.21 Talentët e Klinës

Ngjarja Kulturore është organizuar me iniciativën e dy të rinjëve të Qendres Rinore, të cilat ishin dy vajza që merren me muzik dhe dëshira e tyre ishte që të shfaqen talentët e Klinës. Qendra Rinore Ardhmeria përkrahu këtë iniciativë dhe bëri të mundur performancën e 15 talentëve të rinjë, ku Juria zgjodhi dy talentët më të mirë, ndërsa publiku votoi me duartrokitje dhe përzgjedhi fitues Këngën "It ëill rain" e kënduar nga Rina Balaj dhe Erion Palucaj.

Përgezohim të gjithë talentët që moren pjesë dhe prania e tyre e bëri programin tonë madhështor dhe gjithashtu kënga e tyre kontriboi në mbledhjen e fondit për bamiresi.

Bashkëpunim: Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.



## 2.22 Party për vitin e ri

Për të përmbledhur dhe reflektuar të gjitha aktivitetet gjatë vitit Qendra Rinore Ardhmeria festoi së bashku më të rinjtë rikujtuam aktivitetet e realizuara të vitit 2015, Festa përmbyllesë e vitit filloi me kuiz edukativ, lojra dhe muzik për të rinjtë. Ceremonia u përmbyll me shpërndarje të Mirënjohjeve për antaret që ishin aktiv gjatë vitit 2015 si dhe me dhurata nga vet të rinjtë.

\*\*\*Gëzuar Viti ri 2016\*\*\*



### **3 . BASHKËPUNIMET / PARTNERSHIPS**

#### **3.1 "#YOUTHMENTARY: EVS for youth workers"**

Trajnimi është organizuar me qëllim të rritjes së bashkëpunimit të projekteve rinore dhe specifikisht për projektet e shkëmbimeve(EVS) në mes të partnereve. Trajnimi është organizuar nga Arci në qytetin Nicolasi dhe ka zgjatur 8 ditë, nga qendra Ardhmeria moren pjesë dy të rinjë që ishin pjesë e 28 të rinjëve nga vendet e ndryshme europiane.

*Implementuar në Nicolasi-Italy prej 6<sup>t</sup> -13 Maj 2015*

#### **3.2 "MotivACTION" trajnim 8 ditor në Nicolasi-Itali**

është organizuar nga Arci, qëllimi i këtij projekti ishte që të rinjët nderkombtar të ftuar në një vend të takohen dhe të fillojnë të iniciojnë idetë e reja për shkëmbimet Rinore në Evropë. Nga qendra janë moren pjesë dy të rinjë dhe përfaqësuan Kosovën.

*Implementuar në Nicolasi-Italy prej 10 -17 Qershor 2015*

#### **3.3 Projekti "For a better Unity-Active in our community"**

është organizuar nga partneret tonë FoTA nga Suedia, gjatë muajit Korrik një Grup i të rinjëve nga FoTA vizituan qytetin e Klinës dhe vendosën që të zhvillojnë një bashkëpunim në mes të Kosovës dhe shtetit Suedez në vjeshtë të vitit 2016. Projekti u realizua në Lund të Suedisë dhe mundësoi që 7 të rinjë të Klinës të marrin pjesë në këtë projekt dhe të vizitojnë organizatat rinore dhe gjithashtu të shkëmbejnë aktivitete Kulturore në mes të grupit rinor. Në këtë projekt moren pjesë 7 të rinjë nga Kosova, 7 të rinjë nga Serbia dhe 7 të rinjë nga Suedia.

*Implementuar në Lund-Suedi prej 20 -27 Tetor 2015*

#### **3.4 Vizitat Rinore me autoritetet Lokale në Klinë**

Në Kuader të projektit " Rritja e ndergjegjjes publike" e cili është financuar nga ambasada amerikane në Prishtinë dhe implementuar nga organizata Human nga Peja, ku ne si qendër rinore jemi të involvuar si palë e tretë për të organizuar takime rinore me autoritetet lokale në komunën e Klinës. Gjatë 12 muajve të vitit 2015 kemi arritur të zhvillojmë 15 vizita Rinore me drejtorit e ndryshme të autoritetit Lokal, përgjegjës të sektoreve dhe institucioneve lokale në përgjithësi. Secila vizite ka pasur 10 të rinjë ku gjatë takimeve të drejtpërdrejta dhe diskutimeve një numër shumë i madh të rinjesh kanë marrur njohuri dhe informata për sistemin e punës në institucione të Klinës dhe përgjegjësit dhe transparencën e tyre ndaj publikut.

Gjatë këtij projekti kemi vërejtur se të rinjët nuk janë shumë të aktivizuar në jetën publike dhe se projektet e tilla janë shumë profitabile për vetëdijësimin e të rinjëve dhe qytetareve.

*Implementuar në Klinë prej 03 mars-30 dhjetor 2015*

#### 4. STATISTICS /BENEFICIARIES

